



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 412 , datë 15.6.2022

P Ë R

PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE,
NË BASHKITË KAMZË DHE LEZHË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 152 560 950 (njëqind e pesëdhjetë e dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para sipas aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Kamzë dhe Lezhë, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Kamzë, në masën 127 500 000 (njëqind e njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë;
 - b) Bashkisë Lezhë, në masën 25 060 950 (njëzet e pesë milionë e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.
2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkitë Kamzë dhe Lezhë, në masën 91 536 570 (nëntëdhjetë e një milionë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të

banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para sipas aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 76 500 000 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë;
 - b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 15 036 570 (pesëmbëdhjetë milionë e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë.
3. Efekti financiar për vitin 2022 të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe u transferohet bashkive Kamzë dhe Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.
 4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë dhe Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHITIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 3423/1
DATË 16.6. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE KAMZË DHE LEZHË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

